

Njoftim i aplikimeve për licencim

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë si vijon:

- shoqëria “DOMA GROUP” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Vinjolli 1”, me kapacitet të instaluar 1.840 MW, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, Qarku Dibër;
- shoqëria “GLOBAL INTERPRISE GROUP” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 MW, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

Në mbledhjen e datës 15.06.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e secilës prej shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me secilën kërkesë për licencim, brenda 10 (dhjetë) ditëve (nga data 16.06.2026 deri më 25.06.2026) pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.